



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TE PËRGJITHSHËM

U R D H Ë R

NR. 149, DATË 09. 05.2008

PËR

PËRDORIMIN E MODELEVE TË DISA AKTEVE KRYESORE PROCEDURALE PENALE

Me synim,

- për të ndihmuar oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore, si dhe prokurorët në plotësimin e disa akteve kryesore procedurale penale;
- për të përmirësuar cilësinë e tyre, si dhe;
- për të unifikuar praktikën e formulimit të tyre në policinë gjyqësore dhe në Prokuroritë e të gjitha niveleve;

Në mbështetje, të nenit 118 e vijues të Kushtetutës, të neneve 24 pika 4 e vijues të K. Pr. Penale dhe të nenit 8 pika 2 e vijues të ligjit nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me ligjin Nr. 9102 datë 10. 07. 2003,

URDHËROJ:

1. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore, si dhe prokurorët të zbatojnë modelet "tip" të akteve procedurale penale, që i bashkëlidhen këtij urdhri, (në formë elektronike dhe të printuara).

1.1. Kur përmasat e modelit të aktit janë të mjaftueshme për shkuarjen e tij, përmbajtja e aktit të shkruhet direkt në modelin përkatës;

1.2. Kur përmasat e modelit të aktit "tip" nuk janë të mjaftueshme për shkuarjen e tij, modeli shërben për të ndihmuar në përgatitjen e aktit në një format tjetër A4, duke u respektuar kërkesat e modelit.

2. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore, si dhe prokurorët, të hedhin modelet "tip" të akteve, në kompjuter dhe/ose në serverin e rrjetit kompjuterik, si dhe të mbajnë në një fashikull të veçantë apo në USB-flash disk, CD ose disketë, kopje të printuara apo elektronike të modeleve "tip" të akteve, duke i marrë me vete sa herë duhet të përpilojnë akte procedurale penale jashtë zyrës së tyre.

3. Drejtuesit dhe prokurorët e Prokurorive të shkallës së parë, brenda datës 1 mars 2008, të instruktojnë oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore, për mënyrën e përdorimit të modeleve "tip" të akteve procedurale penale.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore, si dhe prokurorët.

5. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij urdhri ngarkohen drejtuesit e Prokurorive të të gjitha niveleve dhe prokurorët e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe drejtuesit e seksioneve dhe të shërbimeve të policisë gjyqësore.

6. Me këtë urdhër të njihen oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore, drejtuesit e shërbimeve dhe seksioneve të policisë gjyqësore, si dhe prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorive, të të gjitha niveleve.

7. Mospërmbushja e detyrave të përcaktuara në këtë urdhër, përbën shkelje të disiplinës në punë.

8. Përdorimi i modeleve "tip" të akteve kryesore procedurale penale në zbatim të këtij urdhri fillon në datë 15 maj 2008.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORII PËRGJITHSHËM

INA RAMA

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Ina Rama', written over a horizontal line. The signature is stylized and somewhat abstract.

Kon&Kom KL
9. 05. 08

